

Kushtet e Veçanta për Sigurimin nga Aksidentet Personale

Neni 1 - Rasti i Siguruar

1. Siguruesi ofron mbulimin nga Aksidentet Personale që pëson i Siguruari gjatë ushtrimit:

- a) të veprimtarisë profesionale të treguar në Policën e Sigurimit
- b) të çdo lloj veprimtarie tjetër që nuk ka karakter profesional

Sigurimi nga Aksidentet Personale mbulon aksidentet që pëson i Siguruari:
për shkak të:

- helmimit akut nga thithja apo gëlltitja e substancave;
- mbytjes;
- ngrirjes;
- goditjes së diellit apo nxehtësisë;
- sforcimeve fizike;
- asfiksionit me origjinë jo patologjike;
- mungesës së përvojës ose pakujdesisë;

Siguruesi do të mbulojë edhe rastet e infeksioneve të të Siguruarit si rezultat i hyrjes në trupin e tij të trupave të infektuar nëpërmjet plagëve të shkaktuara nga aksidenti, si edhe infeksionet nga tetanusi apo tërbimi.

Neni 2 - Përjashtimet e Përgjithshme për aksidente personale

1. Siguruesi nuk do të mbulojë aksidentet që pëson i Siguruari për shkak të:

- a. operacioneve luftarake, kryengritjes, përmbajtjes, zhvendosjes së tokës, shpërthimeve vullkanike, tërmeti, katastrofave natyrore;
- b. shpërthimeve dhe diacionit të energjisë bërthamore pavarësisht nga origjina e shkaktimit të tyre;
- c. dehjes, përdorimit të tepruar të psiko farmaceutikëve, drogës ose alucinantëve;
- d. ndërhyrjeve kirurgjikale, kurimit apo kontroleve për pasoja që nuk janë shkaktuar nga aksidentet;
- e. akteve të kryera me dashje ose të tentuara nga i Siguruari;
- f. veprimtarive profesionale sportive (gara apo stërvitore) të cilat nuk janë deklaruar si profesione;
- g. drejtimit të një mjeti fluturimi me motor, qoftë drejtues, pasagjer apo anëtar i ekuipazhit të tij;
- h. përdorimit të aeroplanëve pa motor, qëndrimit si pasagjer në to apo parashutimit;

- i. drejtimit të mjetit motorik ose të lundrimit i pa pajisur me dëshminë përkatëse të aftësisë për të drejtuar;
- j. pjesëmarrjes në gara apo konkurrime sportive të mjetit motorik apo lundrues, qoftë drejtues, pjesëtar ekuipazhi apo pasagjer;
- k. trazirave civile masive apo akteve terroriste;
- l. Epidemitë dhe pandemitë;
- m. Përjashtimet e Coronavirusit – LMA 5391. Kjo policë nuk mbulon asnjë pretendim në asnjë mënyrë të shkaktuar nga ose që rezulton nga:
 - Sëmundja e Coronavirusit (COVID-19);
 - Sindroma e rëndë akute e frymëmarrjes Coronavirus 2(SARS-CoV-2);

Neni 3 - Dëmshpërblimi

1. I Siguruari ose Përfituesi paraqet kërkesën për dëmshpërblim së cilës duhet ti bashkëngjiten të gjithë dokumentet e nevojshme që vërtetojnë Rastin e Sigurimit, pasojat dhe dëmtimet në aksident.
2. Në rast paaftësie të përkohshme, certifikatat mjekësore duhet të ripërtërihen në përfundim të afateve përkatëse.
3. Siguruesi duhet të ofrojë ose të refuzojë dëmshpërblimin brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për dëmshpërblim.
4. Në rast se në momentin e ndodhjes së aksidentit, i Siguruari nuk është fizikisht i plotë dhe i shëndetshëm, janë të dëmshpërblehem vetëm pasojat që do të mund të vërtetoheshin patjetër sikur aksidenti t' i kishte ndodhur një personi fizikisht të plotë dhe të shëndetshëm.
5. Në rast se shkaktohet humbje anatomike ose pakësimi funksional i një organi apo i një gjymtyre të dëmtuar para aksidentit, përqindjet e treguara në tabelën e përfitimeve do të reduktohen duke pasur parasysh shkallën e invaliditetit të mëparshëm.

Neni 4 - Dëmshpërblimi për paaftësi të përhershme

1. Dëmshpërblimi për paaftësi të përhershme llogaritet në bazë të Shumës së Siguar sipas kriteve dhe përqindjeve të treguara në tabelën e përfitimeve.
2. Kur i Siguruari është mëngjarash përqindjet e treguara në tabelë për gjymtyrët e djathta do të vlejné për ato të majta dhe anasjelltas.
3. Në rast të paaftësisë së përhershme jo të treguar në tabelë, dëmshpërblimi përcaktohet duke pasur parasysh shkallën e humbjes së aftësive normale fizike dhe mendore të të Siguarit, pavarësisht nga profesioni i tij.
4. Në rast se i Siguruari pëson humbje anatomike ose funksionale të ndryshme, Siguruesi paguan dëmshpërblim të barabartë me shumën e përqindjeve të paaftësisë së përhershme për çdo humbje por jo më shumë se 100% të Shumës së Siguar.

5. Shumat e siguruara për invaliditet si pasojë e aksidentit janë si më poshtë:

Invaliditeti si pasojë e aksidentit nga lëndimi në punë	3,000 EUR
Invaliditeti nga aksidentet tjera:	1,500 EUR

Neni 5 - Dëmshpërblimi për qëndrim spitalor dhe për kirurgji kozmetike si pasojë e aksidentit

1. Shpërblimi për qëndrim në spital i paguhet të Siguruarit në rast se për shkak të aksidentit ai ndodhet për trajtim mjekësor në spital. Shpërblimi për qëndrim në spital përcaktohet si më poshtë:

Kohëzgjatja e qëndrimit në spital	Përfitimi
Deri në 6 ditë	Zero
7 deri në 14 ditë	100 EUR
15 deri në 21 ditë	150 EUR
Mbi 22 ditë	200 EUR

2. Shpenzimet spitalore dhe farmaceutike inkuadrohen në dëmshpërblimin e ofruar në rast vdekje, paaftësi të përhershme ose të përkohshme.

3. Në rastet kur të siguruarit i rekomandohet kirurgji kozmetike, e cila lind si nevojë nga një aksident, siguruesi paguan shpenzimet e ndodhura për kirurgji kozmetike, sipas vlerës së ndodhur, por jo më shumë se 250 EUR.

Neni 6 - Të drejtat dhe detyrimet

1. I Siguruari duhet të njoftojë me shkrim Siguruesin në rast ndryshimi të veprimtarisë profesionale gjatë periudhës së sigurimit që sjell si pasojë rritjen e rrezikut dhe të primit të sigurimit.

2. Siguruesi cakton një ekspert ose një grup ekspertësh për të kryer ekspertimin e gjendjes shëndetësore të të Siguruarit në bazë të dokumentacionit të paraqitur prej tij.

3. I Siguruari dhe në rast vdekje Përfituesi, duhet të lejojnë Siguruesin të kryejë verifikimet dhe ekspertimet e nevojshme lidhur me aksidentin.

4. I Siguruari duhet të ndjekë këshillat e mjekut dhe duhet të bëjë përpjekje maksimale për të minimizuar pasojat e aksidentit.

TABELA E PËRFITIMEVE

Humbja	Përfitimi i pagueshëm në përqindje ndaj Shumës së Sigurimit të përcaktuar në Formular
A Humbja e jetës	100%
B Paaftësi e Përhershme	
1 Paaftësi e Plotë e Përhershme	100%
2 Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të dy gjymtyrëve	100%
3 Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të një gjymtyre	75%
4 Humbje e plotë e përhershme e shikimit në të dy sytë	100%
5 Humbje e plotë e përhershme e shikimit në një sy	75%
6 Humbje ose humbje e plotë e përdorimit të një gjymtyre dhe humbja e shikimit në një sy	100%
7 Humbje e të folurës dhe dëgjimit	100%
8 Humbje e përhershme dhe e pa kurueshme e shëndetit mendor	100%
9 Humbje e plotë e përhershme e dëgjimit	
a) në të dy veshët	70%
b) në një vesh	20%
10 Humbje e plotë e të folurës	70%
11 Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të pesë gishtërinjve të dorës	
a) të djathtë	50%
b) të majtë	30%
12 Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të katër gishtërinjve të dorës	
a) të djathtë	30%
b) të majtë	15%
13 Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtit të madh të dorës	
c) të dyja falangat e gishtit të majtë	20%
d) një falangë e gishtit të majtë	10%
14 Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtërinjve të tjerë	
a) tre falanga të një gishti të dorës së djathtë	10%
b) dy falanga të një gishti të dorës së djathtë	7%

c) një falange e një gishti të dorës së djathtë	5%
d) tre falanga të një gishti të dorës së majtë	7%
e) dy falanga të një gishti të dorës së majtë	5%
f) një falange e një gishti të dorës së majtë	3%
15 Humbje ose humbje e plotë e përhershme e përdorimit të gishtërinjve të këmbës	
a) të gjithë gishtërinjtë e një këmbë	10%
b) dy falanga të gishtit të madh të këmbës	5%
c) një falange e gishtit të madh të këmbës	3%
d) secili prej gishtave përveç gishtit të madh	1%
16 Shkurtim i këmbës me të paktën 5 cm	7%
17 Djegie të shkallës së tretë	
Zona Dëmtimi si përqindje e Sipërfaqes së Përgjithshme të Trupit	
- koka e barabartë ose më e madhe se 2% por më pak se 5%	25%
- koka e barabartë ose më e madhe se 5% por më pak se 8%	40%
- koka e barabartë ose më e madhe se 8%	100%
- trupi e barabartë ose më e madhe se 10% por më pak se 15%	25%
- trupi e barabartë ose më e madhe se 15% por më pak se 20%	40%
- trupi e barabartë ose më e madhe se 20%	100%